



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026  
I DETYRUAR - SESIONI I  
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

SKEMË VLERËSIMI

QBNND

Varianti A

9 qershor 2026

**Shënim:** Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, të cilat kanë më shumë mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh dhe me përgjigje të përafërta.

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

**PJESA I**

**Berati**

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë
Pyetja 8	B	1 pikë
Pyetja 9	B	1 pikë
Pyetja 10	A	1 pikë

**Pyetja 11**                      **3 pikë****Përgjigje e plotë:****Kundrinori:** vend të veçantë**Lloji:** kundrinor i drejtë**Me se është shprehur:** grup emëror

- 3 pikë**                      Nëse nxënësi gjen kundrinorin, llojin e tij dhe me se është i shprehur.  
**2 pikë**                      Nëse nxënësi gjen kundrinorin dhe llojin e tij ose gjen kundrinorin dhe thotë me se është i shprehur.  
**1 pikë**                      Nëse nxënësi gjen vetëm kundrinorin.  
**0 pikë**                      Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12**                      **3 pikë****Përgjigje e plotë:****Forma e pashtjelluar foljore:** duke ndihmuar**Lloji:** përcjellore

- 2 pikë**                      Nëse nxënësi gjen formën e pashtjelluar foljore dhe llojin e saj.  
**1 pikë**                      Nëse nxënësi gjen formën së pashtjelluar foljore.  
**0 pikë**                      Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13**                      **2 pikë****Model përgjigjeje:**

Në tekst përshkruhet Berati si një qytet me bukuri të veçantë, me vlera të pasura historike dhe kulturore.  
 - Në këtë tekst theksohet arkitektura karakteristike dhe pamja mbresëlënëse.

- 2 pikë**                      Nëse nxënësi tregon si përshkruhet qyteti i Beratit dhe se çfarë theksohet në të.  
**1 pikë**                      Nëse nxënësi tregon vetëm si përshkruhet qyteti i Beratit ose vetëm se çfarë theksohet në të.  
**0 pikë**                      Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë*

**Pyetja 14**                      **3 pikë****Model përgjigjeje:**

Karakteristikat e tekstit përshkrues:

- Jep një përshkrim të detajuar të një personi, vendi ose objekti.
- Përdor detaje shqisore për të krijuar një pamje të qartë.
- Përdor kryesisht kohën e tashme të foljeve.
- Përqendrohet te cilësitë dhe tiparet.
- Mbizotërojnë mbiemrat.

- 3 pikë**                      Nëse nxënësi rendit tri karakteristika të tekstit përshkrues.  
**2 pikë**                      Nëse nxënësi rendit dy karakteristika të tekstit përshkrues.  
**1 pikë**                      Nëse nxënësi rendit një karakteristike të tekstit përshkrues.  
**0 pikë**                      Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 15**                      **3 pikë****Model përgjigjeje****Detaji 1**                      Përshkrimi i lumit Osum që e ndan qytetin në dy lagje.**Detaji 2**                      Përshkrimi i kalasë.**Shpjegimi:**                      Këto detaje pamore ndihmojnë lexuesin të krijojë një imazh të qartë të qytetit duke e bërë përshkrimin më të gjallë.**3 pikë**                              Nëse nxënësi gjen dy detaje pamore dhe bën shpjegimin e tyre.**2 pikë**                              Nëse nxënësi gjen vetën dy detaje pamore ose gjen një detaj pamor dhe bën shpjegimin e tij.**1 pikë**                              Nëse nxënësi gjen vetëm një detaj pamor.**0 pikë**                              Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 16**                      **3pikë****Përgjigje e plotë:****Fakti**                              Berati është pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.**Opinion**                              Për të mos u harruar pa përmendur janë edhe Qendra Mesjetare në Berat dhe kuzhina e famshme e këtij qyteti.**2 pikë**                              Nëse nxënësi gjen një fakt dhe një opinion.**1 pikë**                              Nëse nxënësi gjen vetëm faktin ose vetëm opinionin.**0 pikë**                              Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**PJESA II****Viktor Hygo****Katedralja e Parisit****Pyetja 17**                      **B**                      **1 pikë****Pyetja 18**                      **C**                      **1 pikë****Pyetja 19**                      **D**                      **1 pikë****Pyetja 20**                      **B**                      **1 pikë****Pyetja 21**                      **D**                      **1 pikë****Pyetja 22**                      **D**                      **1 pikë****Pyetja 23**                      **B**                      **1 pikë****Pyetja 24**                      **A**                      **1 pikë****Pyetja 25**                      **D**                      **1 pikë****Pyetja 26**                      **A**                      **1 pikë**

**Pyetja 27**                      **2 pikë****Përgjigje e plotë:****Ilustrimet:**

1. Por, megjithë këtë shëmtim, tërë figura e tij shprehte një forcë, zhdërvjelltësi dhe guxim të hatashëm.
2. Përrjashtim i çuditshëm nga ajo rregull e përgjithshme, sipas së cilës forca, sikundër bukuria, duhet të burojë nga harmonia.
3. Kuazimodoja, i zymtë e hijerëndë,
4. Kur u duk ky lloj ciklopi

- 2 pikë**                      Nëse nxënësi identifikon dy ilustrime.  
**1 pikë**                      Nëse nxënësi gjen një ilustrim.  
**0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 28**                      **3 pikë****Përgjigje e plotë:**

**Reagimi 1:** mahnitja dhe admirimi.

**Reagimi 2:** sharjet e grave ose magjepsja e burrave që e brohorisin.

**Shkaku :** pamja jashtëzakonisht e shëmtuar e Kuazimodos.

- 3 pikë**                      Nëse nxënësi gjen dy reagimet e turmës dhe shkaku.  
**2 pikë**                      Nëse nxënësi gjen vetëm dy reagimet.  
**1 pikë**                      Nëse nxënësi gjen vetëm një reagim.  
**0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 29**                      **3 pikë****Përgjigje e plotë:**

**Shpjegimi :** Fjalët e Kopenolit e theksojnë edhe më shumë pamjen e shëmtuar të Kuazimodos duke e bërë atë të jashtëzakonshme. Ato e hiperbolizojnë habinë e Kopenolit kur shikon Kuazimodon.

**Marrëdhënia e fjalëve:** Fjalët janë në marrëdhënie kontrasti me njëra-tjetrën.

- 3 pikë**                      Nëse nxënësi bën shpjegimin e plotë dhe zbulon marrëdhënien mes fjalëve.  
**2 pikë**                      Nëse nxënësi bën një shpjegim të pjesshëm dhe zbulon marrëdhënien mes fjalëve.  
**1 pikë**                      Nëse nxënësi zbulon marrëdhënien mes fjalëve.  
**0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 30**                      **3 pikë****Model përgjigjeje:**

Atmosfera e këtij fragmenti është e jashtëzakonshme, entuziaste, euforike. Turma është e magjepsur nga pamja e Kuazimodos dhe e ndarë në dy grupe që reagojnë në mënyra të ndryshme. Disa i shtojnë tensionin atmosferës duke i ngjitur gjithfarë nofkash e disa duke brohoritur.

**Detajet që mund të përdorë:** majmun shëmtaraq, sa i lig, aq edhe i shëmtuar, shëmtim i përsosur, ishin magjepsur e po brohorisin etj.

- 3 pikë**                      Nëse nxënësi bën një përshkrim të plotë me detaje nga fragmenti, përdor gjuhë përshkruese dhe leksik të zgjedhur.
- 2 pikë**                      Nëse nxënësi bën një përshkrim të pjesshëm pa përdorur detajet.
- 1 pikë**                      Nëse nxënësi identifikon detajet e atmosferës.
- 0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 31**                      **4 pikë****Përgjigje e plotë:**

**Detajet fizike :** alamet koke, e mbuluar me flokë të kuqërremtë e të kreshpëruar; një gungë e madhe midis dy supeve etj.

**Detajet shpirtërore:** i zyrtë e hijerëndë, guxim të hatashëm.

- 1 pikë**                      Nxënësi merr 1 pikë për çdo detaj që identifikon.
- 0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 32**                      **1 pikë****Model përgjigjeje:**

Autori zgjedh të mos u japë emra personazheve, sepse synon të përgjithësojë përshtypjen e tyre për Kuazimodon.

- 1 pikë**                      Nëse nxënësi bën shpjegimin e kësaj zgjedhje nga autori.
- 0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**PJESA III****Pyetja 33**                      **8 pikë**

Për pjesën ese do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

**Shtjellimi i idesë**                      **2 pikë**

- shkruan një ese, e cila mbështetet në rëndësinë që kanë udhëtimet në jetën e njeriut ose në çdo përvojë personale të nxënësit lidhur me këtë temë;
- shtjellon përjetime nga ngjarje të cilat kanë ndikuar në jetën e tij;
- shtjellon ngjarje që i kanë ndryshuar këndvështrimin për botën;
- sjell përfytyrime në formën e historive të krijuara;
- zbërthen bërthamën e temës së dhënë .

**Organizimi dhe struktura** **2 pikë**

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje – zhvillim – mbyllje;
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

**Stili dhe origjinaliteti** **2 pikë**

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

**Saktësia gjuhësore** **2 pikë**

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

**Shënim:** Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.